



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 2316 Prot.

Tiranë, më 24.03.2023

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1834, datë 13.06.2017.

SHOQËRISË “GULF MINING MATERIALS AL” SH.P.K
Lagjja “Uznovë”, Rr. “Antipatrea”, godina me nr. pasurie 235/1008, Berat.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “GULF MINING MATERIALS AL” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1834, datë 13.06.2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në Objektivin “Gryka Devrie”, Bashkia Skrapar, Qarku Berat.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.1283, datë 27.02.2023, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.2316, Prot, datë 28.02.2023, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1834, datë 13.06.2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në Objektivin “Gryka Devrie”, Bashkia Skrapar, Qarku Berat, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2022-2023.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1834, datë 13.06.2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në Objektivin “Gryka Devrie”, Bashkia Skrapar, Qarku Berat që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1834, datë 13.06.2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në Objektivin "Gryka Devrie", Bashkia Skrapar, Qarku Berat, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

